

1 E premte, 27 tetor 2023

2 [Seancë e hapur]

3 [Seancë apeli]

4 [Apeluesi hyn në sallën e gjyqit]

5 --- Seanca fillon në orën 9.32

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PIKARD: [Përkthim]

7 Mirëmëngjes. Mirëmëngjes, të gjithëve.

8 Sot do të vazhdojmë me ndëgjimin e apelit të z. Mustafaj
9 kundër aktgjykimit të Dhomës Gjyqësore të datës 16 dhjetor
10 2022. Do të vazhdojmë si vijon. Është ndryshuar pak rendi i
11 ditës.

12 Domethënë, së pari do të dëgjojmë ZPS-në për 15 minuta,
13 sikurse vendosëm dje, në mënyrë që ZPS-ja të ketë mundësi të
14 flasë për përcaktimin e dënimit, domethënë, deri në orën 9.45
15 minuta. Prej 9.45 deri në 11.00 do ta dëgjojmë Mbrojtësen e
16 Viktimave. Dhe më pas në orën 11.00 do të bëjmë një pushim
17 prej 30 minutash. Nga pra 11.30 deri në 12.00 brenda këtij
18 gjysëm orëshi do të dëgjojmë parashtrimet përfundimtare të
19 Avokatit Von Bone. Dhe pastaj 10 minuta do ta dëgjojmë z.
20 Mustafa dhe do ta mbyllim seancën.

21 Përpara se t'ia jap fjalën ZPS-së, do t'ju kërkoj palëve
22 dhe Mbrojtëses së Viktimave që të japin paneleve kopje të
23 burimeve ligjore të cilave ju referohen gjatë parashtrimeve
24 gojore dhe atë sa në shpejt që është e mundur. Dhe sipas
25 nevojës edhe përkthimet e tyre në anglisht.

1 Tani, më falni, harrova të paraqes lëndën, po këtë do ta
2 bëjmë tash.

3 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar
4 Gjykatës. Kjo është lënda numër KSC-CA-2023-02 Prokurori i
5 Specializuar kundër Salih Mustafës.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PIKARD: [Përkthim]
7 Faleminderit.

8 Do ta dëgjojmë tani ZPS-në, parashtrimet e ZPS-së në 15
9 minutat e ardhshme.

10 Z. BAARKLINK: [Përkthim] Një nga çështjet që nuk e
11 trajtova dje është standardi i synimit kriminal për vrasjen e
12 paligjshme dhe ju, të nderuar Gjykatës, keni parashtruar
13 pyetje në lidhje me këtë në parashtrimin F00030.

14 Pyetja e parë është se çfarë synimi nevojitet për akuzën
15 e vrasjes së paligjshme?

16 Dhe përgjigja jonë në këtë është si vijon standardi i
17 synimit kriminal apo *mens rea*. Për vrasjen e paligjshme
18 sikurse mbështet nga burime të jurisprudencën ndërkombëtare
19 është ose synimi për të vrarë ose shkaktimi i qëllimshëm i
20 lëndimeve të rënda fizike kur kryesi logjikisht duhet ta kish
21 ditur se veprimi ose mosveprimi mund të çonte në vdekje të
22 viktimës. Domethënë, synimi për të vrarë dhe shkaktimi i
23 qëllimshëm i lëndimeve fizike.

24 Pyetja e dytë që parashtrohet është si duhet të
25 përkufizohet synimi i zbatueshëm?

1 Dhe sipas nesh, kjo nuk është një pyetje që ju, të
2 nderuar Gjykatës, duhet ta zgjidhni në këtë çështje sepse
3 Trupi Gjykues në mënyrë të arsyeshme konstatoi se z. Mustafa
4 dhe vartësit e tij të BIA-s vranë qëllimisht viktimën e
5 vrasjes së paligjshme. Dhe ju, të nderuar Gjykatës, së pari
6 duhet të vlerësoni nëse konstatimi i Trupit Gjykues lidhur me
7 synimin e z. Mustafa ishte i gabuar që do të thotë se
8 vlerësimi i provave nga Trupi Gjykues është tërësisht i gabuar
9 ose se prova të tilla nuk mund të ishin pranuar nga ndonjë
10 gjykues i arsyeshëm i fakteve.

11 Ju, të nderuar Gjykatës, në veçanti, duhet të vlerësoni
12 faktin se synimi i z. Mustafa nuk mund të deduktohet nga
13 asnjëri prej këtyre dy kritereve. Në fjalë të tjera, Trupi
14 Gjykues konstatoi se ai kishte synimin për të vrarë, po në
15 qoftë se provat nuk mund ta përcaktojnë se ai kishte të paktën
16 synimin për të shkaktuar lëndim të rëndë fizik dhe se
17 logjikisht duhet ta kishte ditur se veprimet dhe mosveprimet
18 do të çonin në vdekje dhe në qoftë se provat nuk e vërtetojnë
19 këtë, për mendimin tuaj, ju, të nderuar Gjykatës, duhet ta
20 merrni parasysh përkufizimin e synimit.

21 Sipas nesh provat në mënyrë të prerë vërtetojnë se z.
22 Mustafa të paktën në mënyrë të qëllimshme shkaktoi lëndime të
23 rënda me dijeni se kjo mund të çonte në vdekje. Ka disa
24 faktorë në aktgjykimin nga të cilat mund të nxirret ky
25 deduktiv. Është prania e z. Mustafa në atë kompleks. Kompleksi

1 ishte i vogël. Pjesëmarrja e tij e drejtpërdrejtë në
2 keqtrajtimin e të burgosurve tjerë, duke përfshirë përdorimin
3 e armëve të zjarrit, të shkopinjve të bejsbollit dhe kështu me
4 radhë.

5 Nga këto aspekte, dikush, një gjykues i arsyeshëm faktesh
6 mund të nxjerrë përfundimin në lidhje me dijenie dhe elementin
7 e cënueshmërisë.

8 Vendimi për të mos e liruar apo mos e evakuuar viktimën e
9 vrasjes, që sipas konstatimit të Trupit Gjykues ishte bërë nga
10 z. Mustafa. Motivi për të parandaluar viktimën nga raportimi i
11 personave të përfshirë në atë krim. Dhe ajo që deklarata e
12 mëparshme e z. Mustafa se do t'i pengonte procedurat në lidhje
13 me atë vrasje.

14 Dhe, përsëri, do ta theksoj versionin më të dobishëm për
15 z. Mustafa, që është, ai e la atë njeri në gjendje ku nuk mund
16 të ecte dhe në prag të vdekjes, njeri që ishte nën ndalimin e
17 tij në gjendje ku ishte në rrezik të drejtpërdrejtë të
18 vdekjes.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PIKARD: [Përkthim] Kemi një
20 pyetje për ju.

21 GJYKATËSI AMBOS:[Përkthim] Kam dy pyetje për synimin.

22 Në paragrafin 688, Trupi Gjykues e përcaktoi synimin e
23 duhur, si diçka që është shkaktuar në mënyrë të qëllimshme. Ne
24 nuk kemi një përkufizim të përgjithshëm në ligjin tonë të
25 synimit. A mendoni që një shkallë më e ulët e synimit se

1 synimi i drejtpërdrejtë, për shembull, synimi i dyfishtë është
2 i përfshirë në ligjin tonë? Kjo është pyetja e parë.

3 Dhe pyetja e dytë është: A mund të deduktohet nga
4 aktgjykimi se i pandehuri ishte në dijeni të kushteve të
5 viktimës së vrasjes? Dhe në qoftë se po, kur?

6 Z. BAARKLINK: [Përkthim] Në lidhje me pyetjen e parë,
7 ekzistojnë burime ligjore për sugjerimin në lidhje me synimin
8 e vrasjes që përfshin një nivel më të ulët të synimit që çon
9 në të njëjtin rezultat. Në Dhomën e Apelit e ICCC-së në një
10 çështje konstatoj se synimi për vrasje gjithashtu përfshin
11 pakujdesjen ose në latinisht *dolus eventualis*. Aktgjykimi në
12 çështje Karadzic nxori një përfundim të ngjashëm. Dhe
13 referencat për këtë janë paragrafi 490 në rastin e parë dhe në
14 rastin Karadzic paragrafët 447, 448.

15 GJYKATËSI AMBOS: [Përkthim] Po pse është kjo relevante
16 për us [në anglisht]? Atëherë pse ju nuk përdorni ligjin e
17 Kosovës për ta përcaktuar synimin? Pse ju i referoheni
18 praktikës gjyqësore të tribunalit për ish-Jugosllavinë?

19 Z. BAARKLINK: [Përkthim] Ju, të nderuar Gjykatës, e
20 zbatoni të drejtën zakonore ndërkombëtare dhe, për mendimin
21 tonë, pjesa më e madhe e ligjit penal të Kosovës, nuk thotë
22 diçka më shumë krahasim me jurisprudencën tjetër në lidhje me
23 përkufizimit e synimit kriminal për vrasjen e qëllimshme.

24 Prandaj, ju referoj përsëri në nenin 3, që jep udhëzime
25 sesi të zgjidhet interpretimi i të drejtës zakonore

1 ndërkombëtare në këtë aspekt. Gjithashtu edhe neni 38 i
2 statutit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë jep një
3 përkufizim të tillë. Dhe këto japim shpjegime më thelbësore në
4 krahasim me një juridiksion të vetëm të një shteti.

5 Për t'ju përgjigjur pyetjes tuaj të dytë. Në thelb, është
6 një deduktim se synimi apo dijenia, më falni, e z. Mustafa
7 mund të nxirret nga një spektër faktorësh të ndryshëm bindës,
8 dhe disa prej tyre i kam përmendur.

9 Si, për shembull, prania e tij gjatë disa periudhave kyçe
10 të ndalimit të viktimës së vrasjes. Prania e tij në ditën kur
11 ai arriti aty dhe prania e tij në disa ditë, periudha të më
12 pashme dhe në ditën e lirimit të tij. Gjithashtu vendimi që të
13 mos lirohet dhe të evakuhet si dhe të mos i ofrohet ndihmë
14 mjekësore viktimës së vrasjes së paligjshme mund të ishte
15 marrë vetëm prej z. Mustafa. Dhe nga këto faktorë mund të
16 deduktohet se kjo duhet të jetë bazuar në dijeninë për
17 ndalimin e viktimës për vrasjen e paligjshme.

18 Përsëri po e theksoj, se bëhet fjalë për një kompleks të
19 vogël, ku është mbajtur një numër relativisht i vogël i të
20 burgosurve. Dhe duke marrë parasysh shtrirjen, planimetrinë e
21 kompleksit, i vetmi përfundim i arsyeshëm se ai kishte dijeni
22 të mjaftueshme për ndalimin e këtij personi. Dhe për gjendjen
23 e tij që ishte në prag të vdekjes. Dhe, në versionin më të
24 favorshëm për z. Mustafa, ai ka lënë pas një person që nuk
25 është në gjendje të ecte dhe në prag të vdekjes në një situatë

1 kur të gjithë të tjerët u evakuuan. Dhe nga kjo mund të
2 nxirret i vetmi përfundim, se ai duhet ta kishte ditur,
3 konkretisht për gjendjen e viktimës së vrasjes.

4 Për ta rrumbullaksuar parashtrim tim në lidhje me synimin
5 kriminal.

6 Ne parashtrojmë se, në qoftë se ju, të nderuar Gjykatës,
7 devijoni nga jurisprudenca që interpreton se cili synim është
8 i nevojshëm për vrasjen kjo nuk do të ndryshonte rezultatin e
9 aktgjykimit, sepse të paktën z. Mustafa në mënyrë të
10 qëllimshme shkaktoi lëndime të rënda trupore të cilat ai duhet
11 ta dinte se të çonin në vdekje.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PIKARD: [Përkthim] Kemi kaluar
13 kohën.

14 A do të përfundoni tani apo do të bëni dhe parashtrime të
15 tjera në lidhje me caktimin e dënimit?

16 Keni edhe disa minuta për këtë.

17 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar Gjykatës
18 dhe çmojmë që na dhatë kohë shtesë.

19 Në lidhje me caktimin e dënimit dhe parashtrimet me
20 kushtetutshmërinë që u bënë dje, e referoj Panelin që të
21 shikojë paragrafët 32 dhe 33 të parashtrimit F00262 në
22 çështjen Thaçi dhe të tjerët. Atje diskutohen dispozitat
23 kushtetuese dhe shpjegohen sepse ligji për DHSK-në i adreson
24 krimet sipas të drejtës zakonore ndërkombëtare.

25 Dhe aty janë edhe konstatimet e Dhomës së Apelit të bëra

1 në vendimin IA009-F0030, konkretisht paragrafët 39, 56 dhe 57.

2 Tani do të trajtoj shkurtimisht aspektet që lidhen me
3 pyetjet e parashtruara nga Paneli.

4 Dënimi me 26 vjet burgim është i drejtë dhe proporcional.
5 Proporcionaliteti në këtë kontekst para së gjithash ka të bëjë
6 me lidhjen apo raportin midis peshës së veprës penale dhe
7 përgjegjësisë z. Mustafa për këto. Trupi Gjykses e bëri këtë
8 vlerësim me kujdesin më të madh në këtë çështje gjyqësore duke
9 nxjerrë një numër konstatimesh të rëndësishme.

10 Mbrojtja ka bërë thjeshtë deklaratë të thatë se për të
11 njëjtin lloj krimesh nuk ekziston dënim me burgim kaq të gjatë
12 në tribunalët ndërkombëtarë. Ka disa arsye pse kjo nuk
13 demonstroi ndonjë gabim në dënimin e dhënë. Para së gjithash,
14 Trupi Gjykses ka kompetencë të gjerë diskrecionale në
15 përcaktimin e dënimit të duhur duke marrë parasysh rrethanat
16 personale të të akuzuarit dhe peshën e krimit. Si dhe faktorët
17 rëndues dhe lehtësues, që do të thotë se një dënim mund të
18 jetë i konsiderueshëm edhe kur lidhet me të njëjtin lloj
19 krimi. Nuk mund transportohet apo të merret një dënim prej një
20 rasti dhe thjeshtë të transpozohet në një rast tjetër.

21 Për të nxjerrë një konkludim se dënimi është kapriçoz apo
22 i tepruar duhet të deduktohet se është jashtë çdo proporcioni
23 të arsyeshëm me dënimet e dhëna me rrethana të ngjashme për
24 krime të njëjta.

25 Megjithatë, në qoftë se do të bëhet një krahasim, ne duam

1 të theksojmë dy pika. E para, duhet të merret parasysh
2 shkallëzimi apo spektri i masës së dënimit siç keni theksuar
3 në apelin Gucati dhe Haradinaj. Sikurse ka theksuar me të
4 drejtë Trupi Gjykses, sipas ligjit të Kosovës në atë kohë,
5 krimet e luftës meritonin dënime më të mëdha të disponueshëm.

6 Dhe duke marrë parasysh peshën e brendaqënësishme të
7 krimeve në fjalë, ekzistencën e faktorëve të shumtë rëndues
8 dhe nivelin e lartë të kontributit të z. Mustafa në ato krime,
9 dënimi që caktoi Trupi Gjykses ishte, në fakt, brenda dënimit
10 të ulët dhe mesatar të paraparë me ligjet për ato krime.

11 E dyta, krahasimi nuk duhet të kufizohet vetëm tek
12 tribunalët ndërkombëtarë. Në praktikën aktuale, pjesa më e
13 madhe e krimeve ndërkombëtare tani po ndiqen penalisht përpara
14 gjykatave vendore. Për shembull, Chuckie Taylor është dënuar
15 me një dënim prej 90 vjetësh në Shtetet e Bashkuara. Ky dënim
16 përbëhet nga një numër dënimesh më vete, si për shembull,
17 dënimi për komplot për të kryer torturë, ishte 20 vjet,
18 gjithashtu edhe në lidhje me Pikat 5, 6 dhe 7 që kishin të
19 bënë me torturën e një viktime u dha dënim prej 10 vjetësh
20 për secilën pikë. Kjo është në çështjen e Shteteve të
21 Bashkuara kundër Belfast.

22 Në vitin 2021, një gjykatë e Holandës dha një dënim prej
23 20 vjetësh për një sirian që kishte kryer krimin e luftës të
24 vrasjes së paligjshme dhe ky dënim lidhej, që është
25 domethënëse, me një vrasje të vetme pa i shtuar faktorin

1 rëndues të ndalimit të paligjshëm ku shumë civilë, viktima
2 civile u mbajtën, u kërcënuan dhe u torturuan.

3 Me kushtet që i përmenda të zbatueshme për jurisprudencën
4 ndërkombëtare, dua të theksoj, se të njëjtat kushte vlejné
5 edhe për çështjet para gjykatave vendore. Ne nuk po bëjmë
6 krahasim faktik. Dhe kjo nuk është kurrfarë baze për të
7 konstatuar se Trupi Gjykses keqpërdori kompetencën e vetë
8 diskrecionale.

9 Dhe pika e fundit që duam të theksojmë. Edhe në qoftë se
10 do të rrëzohej vendimi i fajësisë së z. Mustafa në lidhje me
11 ndonjë të prej akuzave, konstatimet faktike të Trupit Gjykses
12 në lidhje me peshën e sjelljes penale të të akuzuarit,
13 rrethanat e tija individuale dhe faktorët zbutës dhe rëndues,
14 nuk ndikojné në mënyrë materiale në qoftë se ndonjë element i
15 një krimi konstatohet se nuk është provuar.

16 Trupi Gjykses i konfirmoi ato dënime të cilat qëndrojnë
17 për krime mjaft të rënda.

18 Në shembull për këtë është një aktgjykim i apelit
19 Renzaho, paragrafët 620 dhe 621.

20 Dhe ky gjykim është i zbatueshëm edhe në rastin tonë, ku
21 bëhet fjalë për krimin e torturës, që u krye me një mizori të
22 veçantë dhe në të cilën z. Mustafa në mënyrë të drejtpërdrejtë
23 kreu këtë krim kundër dy viktimave dhe kjo meriton një dënim
24 të plotë prej 22 vjetësh, sikurse edhe e dha Trupi Gjykses.

25 GJYKATËSI AMBOS: [Përkthim] Atëherë pyetja që unë kam ka

1 të bëjë me Nenin 44, paragrafi 781 të aktgjykimit.

2 Ne nuk kemi gama ose fasha dënimi. Kështu që neve ose
3 duhet që t'i referohemi kufirit të epërm të parashikuar në
4 nenin 44(1). Ose duhet që të marrim parasysh të drejtën
5 zakonore ndërkombëtare, ose të drejtën e Kosovës.

6 Megjithatë, aktgjykimi në këtë paragraf i drejtohet
7 paragrafit 781 dhe i drejtohet kodit jugosllav, ish-kodit
8 jugosllav, megjithatë nuk e bënë krahasimin e gamës së dënimit
9 në këtë kod, krahasimisht me atë çfarë parashikohet në ligjin
10 e brendshëm të Kosovës.

11 Kështu që thjesht donim t'ju pyesnim, a është në rregull
12 kjo për ju sa i përket interpretimit apo a shikoni ndonjë
13 problem në qoftë se do t'i referohemi Konventës Evropiane për
14 të Drejtat e Njeriut?

15 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, Trupi
16 Gjykues konstatoi që gjykatat në Kosovë ose aplikojnë apo
17 zbatojnë ose dënime të ngjashme ose standardet më të ulta
18 minimale.

19 GJYKATËSI AMBOS: [Përkthim] Ku e keni gjetur këtë? Se do
20 na ndihmonte shumë. Sepse ne në 781 nuk është se e gjetëm këtë
21 poshtëshënim. Nuk e di nga e gjetët burimin dhe ku e keni bërë
22 këtë krahasim, ku mendoni se mund të mbështetet një krahasim i
23 tillë?

24 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, bëhet fjalë
25 për poshtëshënimin në të njëjtin paragraf, domethënë, është

1 poshtëshënimi 1629, ku:

2 "Trupi Gjykses shënon gjithashtu që ka ligje përkatëse
3 pasuese ose kode të tjera të miratuara në Kosovë të cilat
4 parashikojnë gama dënimesh që janë të barabarta ose që janë
5 edhe më të ashpra apo edhe më të rënda sesa aq".

6 GJYKATËSI AMBOS: [Përkthim] Faleminderit.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PIKARD: [Përkthim]

8 Faleminderit. Ky është fundi i parashtrimit të Prokurorisë.

9 Tani më lejoni që t'i jap fjalën Mbrojtëses së Viktimave
10 për të mbajtur fjalën e saj. Keni më shumë sesa një orë në
11 dispozicion, por ideja është që në orën 11.00 të mund të bëjmë
12 një pushim. Megjithatë në qoftë se ju duhet më shumë kohë pas
13 orën 11.00, mund të vazhdoni me parashtrimet tuaja pas
14 pushimit.

15 ZNJ. PUES: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

16 Mirëmëngjes, të gjithëve, ju që na ndiqni këtu në sallë dhe të
17 tjerë që na ndjekin nga larg. Faleminderit që më dhatë fjalën.

18 Do të dëshiroj që të jap një parashtrim të Mbrojtjes së
19 Viktimave dhe për çështje planifikimi dua t'ju them të
20 gjithëve, që nuk më nevojitet një orë as një orë e 15 minuta,
21 besoj që do jem shumë herë më e shkurtër në parashtrimet e
22 mia. Pas seancës së djeshme, ne bëmë rishikimin e
23 parashtrimeve tona në mënyrë të tillë që të mos përsërisim dy
24 herë të njëjtën gjë.

25 Atëherë më lejoni një çast sa të përgatitem dhe pastaj do

1 filloj përnjëherë me parashtrimet e mia.

2 Të nderuar Gjykatës, viktimat që marrin pjesë në këtë
3 çështje gjyqësore shpresojnë që kjo seancë të jetë hapi i
4 parafundit për ta për t'i dhënë fund dhimbjes së tyre.

5 Kur filloi ky gjykim, unë theksova që në fillim sesa
6 kohë, se sa shumë kohë kanë pritur viktimat që drejtësia të
7 vihet në vend. Ndërkohë që tani më në fund shpresojmë që të
8 arrijmë në një pikë ku fundi është i dukshëm. ZPS-ja, sikurse
9 e thashë edhe më herët, ka bërë parashtrime të shtjelluara dhe
10 të zgjeruara për çështje të cilat janë ngritur nga ju, të
11 nderuar anëtarë të Trupit Gjyqësor dhe, si rezultat, nuk është
12 e nevojshme për mua që të ritheksoj edhe njëherë, për
13 shembull, një pjesë të konsiderueshme të jurisprudencës për
14 çështje që kanë të bëjnë me shkakësinë si dhe standardet
15 thelbësore që ekzistojnë për këtë çështje.

16 Po ashtu, Prokurorja dhe Prokurorët e tjerë kanë theksuar
17 disa prej gjetjeve kryesore nga Trupi Gjyqësor të cilat janë të
18 rëndësishme për këtë çështje dhe kanë theksuar aspekte të
19 rëndësishme se çfarë kanë nxjerrë në dritë dëshmitë gjatë të
20 gjithë këtij procesi gjyqësor. Unë nuk dëshiroj që të përsëris
21 gjërat u thanë dje dhe sot.

22 Megjithatë ajo çfarë është bërë e qartë, për të na
23 vendosur paksa në kontekst, është se jurisprudenca
24 ndërkombëtare si dhe sistemet kryesore ligjore në të gjithë
25 botën, të gjitha kërkojnë një lidhje shkak-pasojë ndërmjet një

1 veprimi ose mosveprimi të një të akuzuari me vdekjen e një
2 personi në një çështjeje vrasjeje. Dhe në mënyrë të ngjashme
3 edhe e drejta penale e Kosovës aplikon nocionin e *conditio*
4 *sine qua non*, kështu që, mund të vendosim dhe mund ta marrim
5 parasysh këtë praktikë edhe në kontekstin e legjislacionit
6 kosovar.

7 Megjithatë është absolutisht e qartë dhe këtë e kemi
8 shqyrtuar në fakt që një vlerësim i tillë është objekt ose i
9 nënshtrohet korrigjimeve normative apo ligjore dhe ajo çfarë
10 në fund fare duhet të përfundojë në pyetje të lidhura me atë
11 çfarë është e arsyeshme dhe me atë çfarë është e drejtë.

12 Dhe në parashtrimin tim këtu dua të përqendrohem sot,
13 pra, dua që të përqendrohem në këtë element shumë të
14 rëndësishëm të procedurës së apelit, pra, të akuzave të
15 vrasjes. Për viktimat e tërthorta që marrin pjesë në këtë
16 çështje është shumë e rëndësishme që të kenë njohuri, të kenë
17 dijeni, që personat e tyre të dashur nuk kanë qenë vetëm
18 viktima të torturës por që humbja e jetës së viktimës së
19 vrasjes ka ardhur si rezultat i vrasjes. Dhe kjo, në fakt, më
20 çon tek pyetja që ju i bëtë ZPS-së të nderuar Gjykatës gjatë
21 seancës së djeshme: A do të ishte e drejtë dhe a do të ishte e
22 arsyeshme në qoftë se ne i atribuojmë vrasjen e viktimës Salih
23 Mustafës edhe në qoftë se shtysa ose goditja përfundimtare
24 mund të jetë realizuar nga forcat armike serbe?

25 Më lejoni t'ju kujtoj, t'i kujtoj audiencës dhe të gjithë

1 personave që na ndjekin këtu, që ky prezumim është më shumë
2 një ushtrim hipotetik por është një ushtrim hipotetik që
3 kërkohet prej ligjit. Në fakt, është rregull që në qoftë se
4 ekziston dyshimi, faktet e çështjes duhet të interpretohen në
5 mënyrë të favorshme për të akuzuarin. Kështu që a do të ishte
6 e drejtë? A do të ishte e arsyeshme që akuza ndaj Salih
7 Mustafës të ishte e qenësishme për sa i takon viktimës së
8 vrasjes?

9 Dhe, nga perspektiva e viktimës, ka vetëm një përgjigje
10 dhe kjo përgjigje është një po e plotë. Po, është në fakt i
11 vetmi përfundim i qartë dhe i arsyeshëm ky shpjegim. Më lejoni
12 t'ju jap shpjegimet se pse mendoj që kjo është gjëja e duhur.

13 Për të dhënë shpjegimet e nevojshme dua që t'ju tregoj
14 pak për përvojën time kur kam udhëtuar drejt Kosovës dhe kur
15 kam shkuar për të vizituar Zllashin kur e kam marrë përsipër
16 këtë çështje në vitin 2021. Kam shkuar atje lart në Zllash dhe
17 mund t'ju them që Zllashi është një vend shumë i izoluar,
18 është një vend në mes të maleve. Është një vend i cili është i
19 mbuluar nga fusha, nga pemë. Dhe disa prej jush, të nderuar
20 Gjykatës, keni parë edhe foto të kësaj zone. Është një zonë
21 shumë rurale. Tani ekzistojnë rrugë, por nuk ka qenë kështu
22 vite më parë.

23 Mund të imagjinohet sesi do gjendej dikush në qoftë se ti
24 lihesh vetëm dhe në qoftë se nuk ke ku të shkosh tjetër. Nuk
25 ka asgjë që mund të të ndihmojë në qoftë se do ishe në një

1 situatë të tillë. Nuk ka asgjë që mund, ti nuk shikon dot
2 asgjë. Aq më pak është ndihmuese situata në qoftë se ti je i
3 dëmtuar, në qoftë se je i lënduar dhe në qoftë se je në një
4 situatë të tillë, ku bëhet përparime nga forcat armike. Dhe
5 këto janë fakte të cilat i ka vërtetuar me qartësi Trupi
6 Gjykues përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, që, në fakt, kjo ka
7 qenë situata ku është gjendur viktimia në atë kohë.

8 Viktimia e vrasjes ishte një person i ri, ishte një i ri i
9 cili deri në momentin kur UÇK-ja e ndaloi atë ishte një person
10 i ri, i fuqishëm, që ishte jashtë Zllashit, larg Zllashit.
11 Por, në fakt, ishte ndalimi, tortura dhe trajtimi mizor dhe
12 ç'njerëzor nga Salih Mustafa dhe vartësit e tij që e bënë
13 viktimën, jo vetëm një qenie njerëzore shumë të cënueshme, por
14 gjithashtu edhe dikë që nuk ishte më i aftë fare që të mbronte
15 veten. Ishte një person që i kishte duart të thyera, me mishin
16 që i binte erë si rezultat i dëmtimeve dhe i lëndimeve që
17 kishte pësuar. Ishte një person që ishte i kequshqyer edhe i
18 masakruar.

19 Të lësh një person të tillë me këto karakteristika në mes
20 të Zllashit, në një vend të tillë si Zllashi, kur nuk ka asgjë
21 të disponueshme, kur nuk ka asgjë që mund të bënte çdokush
22 tjetër po të gjendej në atë situatë për të shpëtuar nga
23 vdekja, pra, është kjo situatë të cilën duhet ta shohim nga
24 afër dhe është pikërisht kjo situatë e cila i atribuohet
25 plotësisht Salih Mustafës. Vetëm veprimet e tij e vendosën

1 viktimën në këtë situatë që sapo përshkrova.

2 Pra, kjo i atribuohet Salih Mustafës si kryesi i vrasjes
3 si komandant dhe drejtues i njësitit BIA, që komanda e tij në
4 mbikëqyrjen e tij dhe në komandën e tij torturoi persona ditë
5 pas dite. Viktima e vrasjes, sikurse e thashë edhe më përpara,
6 nuk do të kishte pasur mundësi të kishte qenë në asnjë vend
7 afër Zllashit dhe jo më Zllash dhe nuk do të kishte pasur
8 mundësi që të ishte në asnjë lloj rreziku, nuk do të përballlej
9 me asnjë lloj rreziku në atë kohë në qoftë se kjo nuk do t'i
10 atribuohet z. Mustafa, kjo është arsyeja sepse unë parashtroj
11 që është e drejtë dhe është e arsyeshme që vdekja e tij, kjo
12 vrasje, t'i atribuohet z. Mustafa.

13 Çdokush që e lë dikë pas, në qoftë se ky person është në
14 situatën që unë përshkrova më sipër dhe në qoftë se situata
15 është e tillë që forcat armike po avanconin dhe po i afrohen
16 vendit, forca armike të cilën njihen për persekutimin e
17 popullsisë shqiptare të Kosovës, pra, jo vetëm që duhet të
18 kishin ditur se cili do ishte fati i personit por e dinin me
19 siguri që ky ishte një vendim me vdekje. Nuk do të kishte
20 pasur mundësi, nuk do të kishte pasur rëndësi, në qoftë se do
21 të kishte pasur një grup ujqërish apo plumba armiqsh apo
22 granatime, pavarësisht nga ajo çfarë mund të kishte ndodhur
23 mbi viktimën dhe shkaqet e tjera. Këto nuk janë të
24 rëndësishme, janë përtej diskutimit. Për aq kohë sa ekziston
25 një skenar i qartë i paevitueshëm që do të shpalosej dhe që do

1 të bënte të mundur bërjen e këtij dallimi.

2 Salih Mustafa e dinte dhe pa diskutim që e parashikonte,
3 që po të lije dikë si viktima e vrasjes në atë situatë, në atë
4 vend, pa dyshim do të çonte në vdekjen e tij.

5 Si kujtesë, ne dëgjuam nga një dëshmitare e Mbrojtjes në
6 fakt, Teuta Hadri, që ishte vetë Salih Mustafa personi që
7 kishte organizuar atë ditë që viktima e vrasjes u la pas, pra,
8 ishte vetë Salih Mustafa që organizoi evakuimin e personave të
9 tjerë që ishin të pranishëm në Zllash. Ai ishte personi vetë
10 që kishte parë rrezikun që e dinte se çfarë po ndodhte dhe që
11 ishte i zënë duke organizuar evakuimin e personave që ishin
12 aty, pra, në ahurin ku viktima e vrasjes u la pas.

13 Nuk theksoj dot mjaftueshëm që nuk kishte absolutisht
14 asnjë ngjarje të re apo të pavarur të materializuar në këtë
15 rast.

16 Në qoftë se ne punojmë dhe përsëri, domethënë, në
17 pikëpamjen time, në nivel hipotetik, por megjithatë në qoftë
18 se prezumojmë apo sugjerojmë që do të ishin forcat serbe ato
19 që kanë shtënë në viktimën, gjithsesi kjo është absolutisht e
20 parashikueshme. Megjithatë, më lejoni të them, që ky nuk është
21 skenari i mundshëm këtu. Është mundësia më e largët e
22 mundshme, megjithatë, po them, që edhe në qoftë se do të
23 kishte qenë ky skenari prapë faji i takon Salih Mustafës.
24 Rreziku ishte i qartë. Evakuimi i Zllashit, i vendit të
25 ndalimit, i kompleksit të ndalimit aty në Zllash ishte që të

1 mbroheshin personat e mbajtur në Zllash.

2 Dhe në qoftë se ju lini në një situatë të tillë persona
3 të lënduar rëndë edhe nëse këta persona më pas vriten nga
4 plumba serbë kjo në vetvete nuk përbën një ngjarje të re të
5 mëvetësishme që mund të shkëpusë zinxhirin e shkakësisë. Dhe
6 nuk mund të zbehë atribuimin penal ndaj z. Mustafa në këtë
7 çast.

8 Tani për një çast më lejoni që të bëj një hap pas nga
9 Salih Mustafa dhe faktet e përcaktuara në këtë çështje apo
10 fakteve të cilat u paraqitën me hollësi në prezantimin e
11 jurisprudencës lidhur me atë çfarë Prokuroria tha.

12 Më lejoni të them diçka për krimin e luftës së vrasjes,
13 vrasjet në të gjitha llojet, pra, e kam fjalën këtu për
14 konfliktet e armatosura jo ndërkombëtare, kjo ekziston dhe
15 parashikohet si shkelje e rëndë dhe jepet në kuadrin e
16 aspektit ligjor në nenin 3 të Konventës së Gjenevës. Ky është
17 një parashikim për krime që ekzistojnë për të zbatuar
18 përputhjen me të drejtën humanitare ndërkombëtare. Ekziston
19 sepse ka si qëllim kryesor që të mbrojë popullsinë ndaj
20 rreziqeve që mund t'ju kanosen atyre. Janë, për shembull,
21 rreziqet e luftës civile për konfliktet e armatosura jo
22 ndërkombëtare të çdo lufte.

23 Në çdo mënyrë, konfliktet e armatosura jo ndërkombëtare
24 mbase janë rrethanat më të rrezikshme për popullsitë civile
25 sepse lufta ju shkon në prag të derës dhe zakonisht luftërat

1 ndodhin në beteja jo klasike. Zakonisht luftëra të tilla
2 ndodhin në fshatra. Në zona nga më të largëta rurale por
3 gjithashtu edhe në qytete. Kështu që për këtë arsye është e
4 rëndësishme për ne për të mbajtur parasysh që krimet e luftës
5 që po diskutojmë këtu janë krime lufte të parashikuara si
6 vepra penale në nenin 3.

7 Dhe në qoftë se ne do të mohojmë atribuimin në një
8 situatë, kur një situatë që është e ngjashme me situatën për
9 të cilën jemi këtu sot, do të bëhej shumë e thjeshtë për
10 kryesit e veprës që të shmangeshin nga vrasjet, vrasjet e çdo
11 lloji dhe çdo natyre. Dhe ata në një situatë të tillë të
12 luftërave jo ndërkombëtare mjafton që të torturojnë apo të
13 lëndojnë, të dëmtojnë deri në masën që forcat e armikut t'ju
14 lënë mjaftueshëm që të bëjnë diçka të vogël fare në mënyrë të
15 tillë që të heqin qafe civilët që janë të pambrojtur.

16 Në qoftë se do të ngrinin pragun e atribuimit në një
17 standard të tillë, siç ne bëjmë atribuimin e luftimeve të
18 parashikueshme të armikut, atëherë në fund do të lejonim
19 situata të cilat të kalonin pa u ndëshkuar, situata, për
20 shembull, që janë edhe shumë të rënda si rasti i vrasjes dhe
21 që të përfundonin në një situatë të tillë edhe personat në
22 fjalë të mund të zhvishnin veten nga përgjegjësi të tilla.

23 Kjo do ta linte rrezikun e bërjes së kësaj dispozite të
24 krimeve të luftës jo efektive dhe jo të zbatueshme dhe kjo në
25 vetvete nuk do të përbënte një rezultat të arsyeshëm. Çdo

1 interpretim i ligjit duhet të synojë që të japë efekt
2 subjektit dhe objektit të dispozitës. Dhe objekti dhe subjekti
3 i dispozitës së "vrasjes së të gjitha llojeve" në nenin 3
4 është që të mbrohen civilët nga rreziqet e luftës dhe rreziqet
5 e rritura të vrasjes, apo që vriten dhe të lihen në rrugë në
6 situata të tilla lufte pavarësisht nga pala.

7 Tani shkurtimisht më lejoni që të shtjellojë pak më tepër
8 aspektin e synimit, aspekt i cili u diskutua dhe sot më herët
9 në mëngjes, dëgjua për jurisprudencën ndërkombëtare dhe me të
10 drejtë ju, të nderuar Gjykatës, bëtë pyetjen për të drejtën e
11 Kosovës. Për neve është absolutisht shumë e qartë, Kodi Penal
12 i Kosovës në nenin 21, qartazi parashikon për synimin më të
13 ulët sesa synimin e drejtpërdrejtë. Ju kërkoj ndjesë se e kam
14 pak të vështirë që ta shikojë ekranin.

15 Por, në nenin 21 të Kodit Penal të Kosovës parashikohet
16 se vepra penale mund të kryhet edhe me synim të drejtpërdrejtë
17 ose eventual dhe më pas vazhdon duke dhënë detaje të më
18 tejshme në paragrafin 3 dhe duke thënë që:

19 "Veprimet e një personi me synim eventual kur ai ose ajo
20 është i ndërgjegjshëm që pasojat e ndaluara mund të ndodhin si
21 rezultat i veprimeve ose mosveprimeve të tij apo saj dhe ai
22 apo ajo vazhdon me ndodhjen e synimit".

23 Pra, kjo është dispozita e cila është e botuar në
24 Fletoren Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe mban datën e 14
25 janar 2019 që është Fletorja Zyrtare numër 2 dhe faqja 5 edhe

1 6 më konkretisht, kjo është për referencë për ju, të nderuar
2 Gjykatës.

3 Pra edhe nëse do t'i kthehemi pyetjes në qoftë se përveç
4 atribuimit dhe shkakësisë, në qoftë se do të flasim për pyetje
5 që kanë të bëjnë me synimin dhe në qoftë se *mens rea* e
6 zbatueshëm që rrjedhin nga e drejta zakonore ndërkombëtare por
7 edhe në qoftë se e shikojmë të drejtën dhe ligjin kosovar,
8 përgjigjen e kemi dhe në to përveçse në të drejtën zakonore
9 ndërkombëtare.

10 Të nderuar Gjykatës, nuk do të diskutoj të gjitha pyetjet
11 që ju keni botuar në urdhrin tuaj sepse unë këtu jam për të
12 përfaqësuar interesat e viktimave, shqetësimet e tyre dhe, për
13 pasojë, do t'i kufizojë parashtrimet e mia në gjëra më të
14 rëndësishme. Pavarësisht kësaj dëshiroj që të shtoj një
15 konstatim tjetër shtesë që ka të bëjë me parashtrimet e
16 Mbrojtjes dhe që lidhet drejtpërdrejt me viktimat që unë
17 përfaqësoj.

18 Mbrojtja, pra, sugjeroi, që Trupi Gjykues ka qenë i
19 anshëm dhe ka zbatuar standarde të dyfishta kur ka bërë
20 vlerësimin e dëshmive të dëshmitarëve. Edhe pse, të nderuar
21 Gjykatës, juve nuk ftuat një diskutim juridik lidhur me këtë
22 çështje, më lejoni të them, që për ne është shumë e
23 rëndësishme që të trajtohet kjo si çështje që drejtësia,
24 sigurisht, mund të vihet në vend vetëm në qoftë se gjykimi
25 bëhet në mënyrë të drejtë dhe të paanshme. Kështu që në këtë

1 aspekt, pra, kjo është shumë e rëndësishme në kërkesën e
2 viktimave për drejtësi dhe për të vërtetën.

3 Ky supozim i standardeve të dyfishta, i anësisë, nuk mund
4 të jetë më larg nga e vërteta sesa kaq. Për ta ilustruar këtë
5 pikë, dua që t'ju çoj në pikën e fillimit fare të fazës së
6 gjykimit ku ne në fakt dëgjuam një pjesë [REDAKTUAR]
7 [REDAKTUAR]
8 [REDAKTUAR] në këtë çështje dhe që kanë dhënë dëshminë e
9 tyre për atë çfarë kishte ndodhur.

10 Për shembull, Dëshmitari i parë 3593, ka kaluar katër
11 ditë marrje në pyetje përpara Gjykate. Thuhet një ditë e
12 gjysëm i është dhënë kohë Mbrojtjes në mënyrë të tillë që të
13 bënte pyetjet e veta. Dhe, në fakt, kjo është një periudhë
14 goxha e gjatë kohe për t'i bërë pyetje [REDAKTUAR]. Dhe
15 njësoj Trupi Gjykues, sepse ky ishte prezumimi që u bë, por
16 Trupi Gjykues në vetvete mori më shumë sesa gjysmë dite në
17 mënyrë që t'i bënte pyetje plotësuese, pyetje shtesë, këtij
18 dëshmitari. Në fakt, [REDAKTUAR]
19 [REDAKTUAR] janë marrë në pyetje në hollësi jo vetëm nga palët po
20 gjithashtu edhe nga anëtarët e Trupit Gjykues.

21 Nuk ka ndodhur që thjesht të jetë pranuar dëshmia e tyre,
22 ashtu siç pyetjet janë bërë nga Prokuroria. Absolutisht nuk ka
23 qenë kështu. Por janë bërë pyetje nga të gjitha palët siç
24 duhet të bëhet në mënyrë të tillë që të kërkohet që të
25 vërtetohet plotësisht ajo çfarë ka ndodhur. Kjo nuk duhet të

1 harrohet edhe për këtë arsye është e gabuar të deklarohet e të
2 thuhet që janë zbatuar standarde të dyfishta nga Trupi
3 Gjykues. Gjykatësit kanë qenë shumë kritikë në çdo situatë të
4 paraqitur, në çdo dëshmitar që ka ardhur këtu.

5 Ky gjykim dhe mënyra sesi është realizuar ai i kanë dhënë
6 Mbrojtjes dhe Salih Mustafës mundësi të njaftueshme që të
7 parashtrojë provat e tyre. Dhe provat e tyre, dëshmitë e
8 dëshmitarëve të tyre nuk ishin bindëse, po kjo në vetvete
9 është një komplet tjetër çështje.

10 Një tjetër pikë e cila u ngrit nga Mbrojtja dhe thjesht
11 dua ta kaloj shumë shpejt, megjithatë kjo është një çështje që
12 ka të bëjë drejtpërdrejt me interesin e viktimave dhe ka të
13 bëjë me kërkesën e Mbrojtjes për një kërkesë për Gjykatën
14 Kushtetuese të Kosovës. Sipas pikëpamjes sime, kjo nuk është
15 asgjë tjetër përveçse një përpjekje, një orvatje e Mbrojtjes
16 për të vonuar procedurat. Nuk ka asnjë çështje juridike që
17 kërkon interpretimin e kushtetutshmërisë apo që kërkon bërjen
18 e një kërkesë për të dhënë një interpretim të dispozitave
19 ligjore nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës.

20 Mendoj, që është në interesin e viktimave që kjo çështje
21 të përfundojë sa më parë të jetë e mundur për t'i dhënë fund
22 dhimbjes së tyre dhe viktimat mezi presin që ta mbyllin këtë
23 kapitull. Më lejoni, ju lutem, që t'ju tregoj disa prej
24 gjërave që ndan me mua viktimat pasi u takuam pas marrjes së
25 vendimit të Trupit Gjykues.

1 Njëri prej këtyre viktimave të tërthorta tha që shqiptimi
2 i vendimit, i aktgjykimit -- ata në momentin kur ishte
3 shqiptuar aktgjykimi ishin ndjerë sikur të kishin marrë pjesë
4 në një tjetër varrim të të afërme të tyre, të familjarëve të
5 tyre. Për ta a ishte njësoj sikur në fund fare t'i jepnin
6 lumturën të dashurit të tyre. Çdo viktimë që ka marrë pjesë në
7 këtë proces gjyqësor ka shprehur qartësisht faktin që
8 aktgjykimi, përfshirë dhe dënimin, është perceptuar si proces
9 i rregullt dhe i drejtë, një njoftim i drejtë dhe i rregullt
10 që reflekton përvojat e tyre.

11 Tani viktimat pjesëmarrëse e kanë vendosur besimin e tyre
12 në duart tuaja, të nderuar Gjykatës, në trupin e apelit për të
13 dhënë një vendim të drejtë në këtë fazë të procesit gjyqësor,
14 një vendim i cili do jetë një tjetër hap për ta drejt
15 vendosjes, mbylljes së kapitullit të ngjarjeve të prillit 1999
16 që i kanë shkaktuar kaq shumë makthe dhe tragjedi.

17 Shumë faleminderit për vëmendjen.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PIKARD: [Përkthim] Ne kemi një
19 pyetje.

20 GJYKATËSI AMBOS: [Përkthim] Në fakt, kam shumë pyetje.
21 Faleminderit shumë për këtë diskutim të përmbledhur lidhur me
22 çështjen e lidhjes shkak-pasojë, fakti që keni bërë një
23 përmbledhje të re të parashtrimeve tuaja.

24 Pra, në qoftë se kemi skenarin kur është pasojë e
25 zbatimit *in dubio pro reo*, pra, forcat serbe vranë viktimën, a

1 do pajtoheshe se forcat serbe apo personi që ka vrarë viktimën
2 do të ishte përgjegjës për vrasje?

3 ZNJ. PUES: [Përkthim] Kjo varet. Varet nga situata në
4 qoftë se ka pasë të shtëna me armë zjarri, sepse ne e dinim që
5 ishte luftë. Ishte gjendje lufte. Dhe jo çdo plumb i shtënë ka
6 shkaktuar vdekje. Pra, varet, ajo e shtëna e plumbit të
7 qëlluar a ishte drejtuar një civil, në qoftë se si atij në
8 statusin e tij si civil. Në qoftë se, po, mund të kemi atëherë
9 mund të kemi dy kryer të ndryshëm të ndryshëm që kanë kryer të
10 njëjtin krim, por njëri nuk kalon përpara tjetrit dhe ndërpret
11 këtë zinxhirin e reagimit.

12 GJYKATËSI AMBOS: [Përkthim] Është në fakt pyetje e
13 thjeshtë. Nuk duam të hyjmë në hollësi në këtë. Të kemi
14 situatën. Ku fillojmë me supozimin, pastaj kemi përgjegjësi në
15 anën tjetër të forcave. Natyrisht, që në këtë gjendje, është e
16 qartë shënjestër civile. Që të parashtrosh argumentin se nuk
17 mund të veçohen, ndahen rastet kur një person lihet pa ndihmë
18 mbrapa dhe ky person vritet nga natyra. Ky është rast ku
19 shkakësia është pohuar, shkakësia ligjore dhe pastaj ndërhyrja
20 e një agjentë të pavarur. Këtë dua të kundërshtoj. Ndoshta ajo
21 që keni harruar në argumentin tuaj ishte që në anën tjetër nuk
22 pandëshkueshmëri sepse ka përgjegjësi.

23 Dhe e vetmja pyetje do të ishte në këtë rast është në
24 qoftë se kemi përgjegjësi të dyfishtë. Në këtë rast, kemi
25 përgjegjësinë e të pandehurit dhe kemi përgjegjësinë e forcave

1 serbe. Dhe kjo është pyetja, pra, çështja ligjore.

2 Duhet të merret parasysh në ekuacionin që ju keni, a
3 pajtoheni me këtë?

4 ZNJ. PUES: [Përkthim] Po, pajtohem. Por mund të kemi dy
5 kryerës që kryejnë të njëjtin krim apo që veprojnë drejt të
6 njëjtit rezultat dhe në këtë rast nuk mund të jetë thjesht
7 çështje e ko incidencës apo se cila rrethanë është
8 materializuar më shpejtë apo kush është përgjegjës për
9 vrasjen, pjesën përfundimtare të vrasjes apo kush bëri
10 tentativë vrasje.

11 Kjo do të çonte në mënyrë arbitrare në rezultate të cilat
12 përfundimisht ndoshta do të kinim dy tentativë vrasje sepse
13 nuk do ishim në gjendje të përcaktonim saktësisht se cili
14 është shkaku përfundimtar, goditja përfundimtare që shkaktoi
15 vdekjen.

16 GJYKATËSI AMBOS: [Përkthim] Po. Dhe pyetja tjetër është
17 në qoftë se thoni që është e arsyeshme dhe e drejtë që t'ia
18 veshësh vrasjen të pandehurit, atëherë si do të merremi me
19 këto rastet e tjera?

20 Kam një sërë rastesh kur dikush është përgjegjës për
21 vrasjen e dikujt mund të vrasë ty, mund të lejë pa ndihmë,
22 pastaj ti vdesë sepse nga të ftohtit apo ku di unë. Por këtu
23 kemi një gjendje një situatë, *in dubio pro reo*, ku keni aktor
24 ndërhyrës, pra, që ka vepruar. Dhe ju keni thënë dhe ZPS-ja ka
25 thënë, që ai është përgjegjës për vrasjen në çdo rrethanë.

1 Në qoftë se kemi prova të mjaftueshme për të vërtetuar që
2 i pandehuri ka vrarë drejtpërdrejt viktimën, atëherë nuk do të
3 ishte problem. Po të kishim këtë nuk do të ishim duke bërë
4 këtë debat. Por rezultati që ju mbroni dhe ZPS-ja janë të
5 njëjtë. Ajo që është dallimi standard në një situatë është ajo
6 diskutuam më parë, pra, që situata vrasëse e drejtpërdrejtë.

7 ZNJ. PUES: [Përkthim] Në qoftë se kthehemi tek disa në
8 jurisprudencë, mund të gjejmë disa shembuj të shumtë në fakt,
9 ku edhe në rastin kur një person tjetër, për shembull, më
10 kujtohet tani një rast në Gjermani, kërkoj ndjesë për rastet e
11 ligjit vendor, pra, të shtetit tim. Edhe në rastin kur një
12 person tjetër qëllon një plumb shtesë një personi që është
13 tashmë i plagosur rëndë, pra, që është një lloj goditje
14 mëshire për ta çliruar atë nga dhimbja edhe aty e kemi,
15 atribuomi i vrasjes, pra, ngelet tek i njëjti person sepse nuk
16 ndërpritet zinxhiri i shkakut dhe pasojës.

17 Pra, sipas mendimit tim, ndërprerja e shkakësisë, ndërhyt
18 vetëm kur kemi diçka që është tërësisht e re dhe nuk është
19 synimi i rrezikut.

20 GJYKATËSI AMBOS: [Përkthim] E kuptoj atë që po thoni ju.
21 Tani më jepni një shembull, ju lutem. Ne po flasim për
22 shkakësinë ligjore, jo faktike. Më jepni një shembull ku
23 zinxhiri i shkakësisë ligjore ndërpritet?

24 ZNJ. PUES: [Përkthim] Kjo është diçka tërësisht e re, një
25 rrezik i ri paraqitet -- nuk do të lexoj shënimet e mia tani.

1 Por në qoftë se, për shembull, le të themi, një person vë një
2 bombë që nuk shpërthen për X arsye dhe pastaj një person
3 tjetër e qëllon këtë person përpara që bomba të shpërthejë
4 ose po përpiqem që të gjejë një shembull më të mirë tani.

5 GJYKATËSI AMBOS: [Përkthim] Jo, faleminderit është
6 shembull i mirë.

7 ZNJ. PUES: [Përkthim] Është një nga ato shembuj ku dikush
8 që vazhdon më tej diçka që është edhe më e ndërtuar.

9 GJYKATËSI AMBOS: [Përkthim] Kjo ndihmon shumë, e kuptoj.
10 Kam edhe një pyetje tjetër. Ju bëtë, paraqitët argumentin e
11 objektivit dhe qëllimit dhe thatë se qëllimi i kësaj dispozite
12 ligjore dhe kjo është pyetja: Cili është qëllimi i dispozitës
13 së vrasjes? Kur flisni për qëllim a është qëllimi që të
14 parandalohet ky rezultat që është rezultati i ndërhyrjes së
15 një personi të tretë është ky qëllim i dispozitës? Apo është
16 qëllim i dispozitës që të parandalojë rezultatin që personi i
17 cili është i pandehuri në këtë rast të vrasë personin?

18 Pra, argumenti i personit apo i subjektit të kësaj
19 dispozite është me dy tehe, sepse siç e dini mund të
20 interpretohet dhe në anën tjetër anasjelltas pra. Dhe në qoftë
21 se e mendoni, në qoftë se do na jepni mendimet tuaja lidhur
22 edhe me këtë pra. Për sa i përket përgjegjësisë së personit të
23 tretë.

24 ZNJ. PUES: [Përkthim] Tani, në mendimin tim, krimi i
25 luftës i vrasjes në këtë rrethanë të veçantë është ndoshta pak

1 më i ndërlikuar sesa vrasja në skenarin e ligjit penal normal,
2 sepse këtu përpiqemi, sepse ka përpjekje të veçanta për të
3 mbrojtur civilët në kohë lufte. Neni 3 i përbashkët i
4 Konventës së Gjenevës përpiqet të bëjë këtë gjë. Pavarësisht
5 se kush vepron në njëerën apo tjetrën anë dhe çfarë bëjnë.

6 Dhe besoj që këtu duhet të fillojmë duke u papërqendruar
7 tek civilët dhe jo që të shohim kryerësit dhe të krijojmë një
8 dispozitë ligjore sa më efikase që është e mundur që të
9 parandalojmë këdo apo veprimet e kujt do të çfarëdolloj mënyre
10 që çojnë në vrasjen e një civili.

11 GJYKATËSI AMBOS: [Përkthim] Pyetja e fundit ka të bëjë me
12 qëllimin, synimin.

13 Ju përmendët nenin 21 të kodit të Kosovës si cili
14 përfshin qartësisht *dolus eventualis*. Në fakt, e la derën
15 hapur, por ZPS-ja nuk e mbylli. Faleminderit që vazhduat më
16 tej.

17 Pyetja ime është: Neni 12 i ligjit tonë thotë që mund të
18 zbatohet ligjin thelbësor të Kosovës për aq kohë sa është në
19 pajtim me ligjin zakonor ndërkombëtar.

20 Tani në qoftë se ju thoni në përgjithësi, jo vetëm ju
21 personalisht, por ZPS-ja, që ligji zakonor ndërkombëtar lejon
22 vetëm synimin e drejtpërdrejtë. Duke parë jurisprudencën, kemi
23 standarde më të ulta në Kosovë. Do të thotë që ligji i Kosovës
24 nuk është i zbatueshëm sepse është në mospërputhje me ligjin
25 zakonor ndërkombëtar? Pra, ka një tension, një mospërputhje

1 mes nenit 3 të përbashkët dhe nenit 12. Kjo është pyetja,
2 konkurrenca e nenit 21 të kodit penal të Kosovës me ligjin
3 zakonor ndërkombëtar. A janë në përputhje apo jo këto dy
4 dispozita ligjore?

5 ZNJ. PUES: [Përkthim] Është pyetje e mirë, por në
6 përpjekje për t'i dhënë një përgjigje kësaj, nuk jam tërësisht
7 e sigurt që janë kaq në kundërthënie këto dy dispozita ligjore
8 saç duket. Shkaktimi i lëndimit trupor duke dikur që kjo mund
9 të çojë tek vdekja. A është kjo gjithmonë synim i
10 drejtpërdrejtë? Apo jo? Ka të ngjarë. Në fakt, nuk mund të
11 kategorizohen në të njëjtën mënyrë. Nuk jam i sigurt që këto
12 dy dispozitat janë kaq larg njëra tjetrës, siç e thoni, në
13 fakt këto përdorin të njëjtën gjuhë në një farë forme, është
14 pak më e ndërlikuar sesa të themi po ose jo, a përputhen.

15 GJYKATËSI AMBOS: [Përkthim] Ky është komenti im i fundit,
16 nuk ndihmon ndonjëherë që të përdorësh ligjin zakonor
17 ndërkombëtare i cili për natyrë është i pasaktë. Është e
18 vështirë në ndonjë rast, në këto raste dhe në raste tjera t'i
19 përgjigjesh pyetjes nëse ligji i Kosovës është në përputhje me
20 ligjin zakonor ndërkombëtar apo ligji francez, gjerman e
21 tjerë.

22 Kjo kërkon që ne kemi standarde të qarta dhe zakone dhe
23 në këtë rast nuk është ashtu. Kjo është çështje e rëndësishme
24 për ne këtu. Faleminderit për vlerësimet tuaja dhe reflektimet
25 tuaja. Faleminderit.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PIKARD: [Përkthim] Besoj nuk
2 kemi përfunduar me pyetjet akoma.

3 GJYKATËSJA JORGENSEN: [Përkthim] Faleminderit. Kisha një
4 pyetje për format e përgjegjësisë dhe format e tjera të
5 përgjegjësisë.

6 Në parashtrimin tuaj, a lirohet dikush nga vrasje apo
7 padrejtësi nëse përgjegjësia e ndihmës dhe mbështetjes, nëse
8 zbatohet ndihma dhe mbështetja?

9 ZNJ. PUES: [Përkthim] E keni fjalën a do të ishte e
10 padrejtë në kuptimin sesi viktimat e pranojnë këtë apo e
11 marrin këtë?

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PIKARD: [Përkthim] Po, lidhur
13 me viktimat. Nga perspektiva nga perspektiva, nga pikëpamja e
14 viktimave.

15 ZNJ. PUES: [Përkthim] Nuk jam e sigurt që viktimat, sepse
16 duhet të inkorporoj këtu perceptimet dhe pikëpamjet e njerëzve
17 normal me qëndrimet e mia ligjore këtu. Por për ta, por Salih
18 Mustafa ishte më shumë sesa ndihmës dhe inkurajues sepse ishte
19 personi përgjegjës aty.

20 GJYKATËSJA JORGENSEN: [Përkthim] Faleminderit.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PIKARD: [Përkthim] Me këtë më
22 në fund përfundojnë edhe parashtrimet tuaja. Kemi akoma 20
23 minuta. Mund të pyes Mbrojtësin e z. Mustafa që të paraqesë
24 parashtrimet e tija? Do ndalojmë deri në 11.00, në qoftë se
25 keni kohë. Pastaj mund të vazhdojmë, mund të rimerrni fjalën

1 pas pushimit.

2 Z. VON BONE: [Përkthim] Që të jem i ndershëm do të
3 preferoja që të bënim një pushim tani dhe që të plotësoja të
4 gjithë elementët me qëllim që të integroj edhe këto që u thanë
5 më parë.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PIKARD: [Përkthim] E kuptoj
7 qëllimin tuaj, por duhet të konsultohemi me përkthyesit, ideja
8 e pushimit është që përkthyesit të kenë pak, të bëjnë një
9 pushim pas një periudhe kohore ku punojnë.

10 Më lejoni të konsultohem me ta.

11 Atëherë do të bëjmë një pushim tani dhe do kthehemi në
12 orën 11.15.

13 Z. VON BONE: [Përkthim] Faleminderit shumë, e nderuar
14 Gjykatëse.

15 --- Pauza fillon në orën 10.42

16 --- Seanca rifillon në orën 11.15

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Tani ftojme
18 Mbrojtësin e të akuzuarit të paraqesë parashtrimet e tij.

19 Keni pak a shumë gjysmë ore, z. Avokat.

20 Z. VON BONE: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar, do të
21 diskutoj disa çështje që u ngritën.

22 Më lejoni të filloj me çështjet që u ngritën nga
23 Prokuroria. Prokuroria tregoi një dokument që, një listë të
24 burgosurish. E pamë atë. Dhe ky dokument në fakt, çfarëdo që
25 të jetë vlera e tij, nuk vlen asgjë në këtë çështje. S'ka

1 vlerë në këtë çështje sepse ky dokument nuk tregon fare ku
2 janë mbajtur njerëzit të ndaluar. Dhe për më tepër, nuk tregon
3 asgjë lidhur me lirimin e ndonjë nga personat e renditur në
4 atë listë apo dikush që mund të jetë i rëndësishëm për këtë
5 çështje.

6 Ky dokument, të nderuar Gjykatës, ishte pjesë e një
7 parashtrimi, një dosje, në atë dosje në faqet të tjera ka pasë
8 ca poshtëshënime dhe në atë poshtëshënim shihej i shkruar emri
9 i një personi që quhej Cali. Tani, ajo që ka ndodhur është,
10 Prokuroria i kombinoi i vuri bashkë këto dokumente, dhe tha, a
11 shihni, ky është përgjegjës, ky është i lidhur me këtë
12 dokument. Në fakt një lidhje e tillë nuk është vërtetuar
13 asnjëherë në asnjë moment. As nga ZPS-ja as nga Trupi Gjykses
14 në aktgjykimin e tij.

15 Për rrjedhojë, sa na përket neve Mbrojtjes, ai dokument
16 s'ka asnjë rëndësi, dhe nuk ka vlerë prove, nuk është provë
17 për sa i përket faktit apo pyetjes nëse i akuzuari ishte
18 personi që mbajti personat e ndaluar apo ku u mbajtën këta
19 persona të ndaluar, dhe deri kur, në cilin moment kohor këta
20 persona u mbajtën të ndaluar.

21 Dhe ZPS-ja parashtron, bën parashtrime, lidhur me
22 shkakësi, çështjen e shkakësisë, duke paraqitur jurisprudencë
23 të gjerë lidhur me këtë çështje. Megjithatë, të nderuar
24 Gjykatës, shembujt që tha ZPS-ja lidhur me këtë çështje janë
25 prezumime, prezumime, supozime, që janë bërë edhe nga, në të

1 njëjtën mënyrë nga Trupi Gjykses. Për shembull, fakti se,
2 çështja se viktime mund të kishte qenë në, nën ruajtjen, nën
3 autoritetin e z. Salih Mustafa është supozim. Nëse ka patur
4 kontakt mes z. Mustafa dhe kësaj viktime. Është, edhe këtu
5 është, edhe ky është supozim që ai pra, personi i ndaluar,
6 është lënë, braktisur, në prag të vdekjes, apo për të vdekur.
7 Për të bërë një pohim të tillë, nuk ka asnjë, nuk ka asnjë
8 provë, në dosjen e lëndës për të bërë një pohim të tillë. Pra
9 është thjesht supozim.

10 Refuzimi, apo, që ai të lirohet, është thjesht supozim.
11 Refuzimi për të mos liruar dikë tregon një lloj veprimi
12 pozitiv nga dikush me qëllim që të bëhet një vlerësim i tillë,
13 nëse ai person duhet të lirohet apo jo. E vetmja gjë që dimë
14 është që persona të caktuar janë liruar dhe personat që kanë
15 dëshmuar këtu në Gjykatë kanë shkuar në vende të tjera, dhe
16 nuk kanë patur kontakt të mëtejshëm me këtë person.

17 Pra, çështja nëse viktime, viktime e vrasjes në këtë
18 çështje u lirua apo jo, dhe kjo, kjo do të ishte edhe vendimi
19 i të akuzuarit, dhe se kjo do të ishte vendimi i të akuzuarit
20 është thjesht spekulim, është supozim dhe bazohet në
21 spekulime.

22 E njëjta gjë vlen me mohimin e të drejtës së ndihmës
23 mjekësore. Ajo që dimë lidhur me këta persona që ishin në
24 ahur, aty ku janë mbajtur të ahur, kudo të ketë qenë ky vend,
25 ata nuk kanë, atyre nuk u është dhënë ndihmë mjekësore. Por,

1 tani kjo s'ka të bëjë fare ose ndoshta mund të themi deri,
2 deri në momentin kur të tjerët, personat e tjerë u liruan, nuk
3 kemi asnjë informacion se çfarë ndodhi pastaj. Dhe nëse në atë
4 moment ai person i është mohuar ndihma mjekësore.

5 Mohimi do të thotë edhe këtu, kërkon pra një lloj vendimi
6 konkret pozitiv. Ne nuk e dimë a ka patur diçka aty që ishte
7 në dispozicion, por nuk e dimë fare nëse kjo gjë i është
8 mohuar atij personi. Ndoshta dhe i është dhënë ndihmë
9 mjekësore. Thjesht nuk e dimë dhe rrjedhimisht kjo bazohet në
10 spekulime dhe edhe në këtë rast kemi të bëjmë me një supozim.

11 Një shembull tjetër që u përdor nga ZPS-ja ishte, siç
12 thotë ZPS-ja, ata refuzuan ta evakujnë. Kush e tha këtë: ne
13 nuk e dimë nëse ky person u evakuua apo jo, apo nëse u
14 refuzua, nuk u pranua që ai të evakuohej. Duhet që këto, prova
15 të tilla të vërtetohen në çështje, në dosjen e lëndës.

16 Dhe së fundi, ishte një citim -- apo jo saktë një citim,
17 por një parafrazim, që dëshmitari 4600 dëgjoi se ky person
18 kishte vdekur. Dhe në fakt dëshmitari i sapopërmendur dha
19 dëshmi lidhur me këtë pikë. Ne i bëmë pyetjen konkrete atij.
20 Nga kush e dëgjuat këtë gjë, se ai kishte vdekur? Dhe ai u
21 përgjigj duke thënë nga [REDAKTUAR], do t'ju jap edhe
22 referencën për këtë, më jepni, t'jua jap pas pak, por të ju
23 siguroj që e kam referencën e saktë, të nderuar Gjykatës.

24 Dhe [REDAKTUAR] u përgjigj kësaj pyetjeje, kur iu bë
25 pyetja konkrete lidhur me emrin e viktimës së vrasjes, [REDAKTUAR]

1 [REDAKTUAR]

2 [REDAKTUAR]. Kjo ajo që tha ai në përgjigjen ndaj kësaj
3 pyetjeje.

4 Pra, Dëshmitari 4600 nuk mund të jetë pjesë e provës që
5 lidhet me -- prova që bazohen në thashetheme, të pambështetura
6 nga prova të tjera, të pambështetura dhe të pakonfirmuara nga
7 burimi i pretenduar i kësaj gjëje në veçanti. Por që
8 pretendohet të jetë thënë pra dëshmitarit 4600.

9 Rrjedhimisht, të nderuar Gjykatës, baza mbi të cilën i
10 gjithë argumenti i shkakësisë është bazuar, ishte supozim dhe
11 supozime, dhe supozimi më i rëndësishëm u la mënjanë në atë
12 rast nga Trupi Gjykses. Dhe këtu bëhet fjalë për prezumimin e
13 pafajësisë. Duhet të sigurohemi nga fillimi më i thjeshtë i
14 çdo, i një qasje në çështje penale, duhet të prezumojmë
15 pafajësinë e personit. Dhe vetëm në momentin kur kemi prova të
16 padyshimta të qarta për të kundërtën, personi mund të shpallet
17 fajtor. Por bazuar në prezumimin nuk besoj që i akuzuari do të
18 kishte, mund të shpallej fajtor.

19 Tani, po kaloj te pjesa e përcaktimit të dënimit.

20 Ligji i zbatueshëm përkatës në atë kohë ishte neni 48
21 [sipas përkthimit] të Kodit Penal të Jugosllavisë. Ky ligj
22 parashihte në dispozitën (1) siç vijon:

23 "Ndëshkimi me burgim nuk mund të jetë më i shkurtër se 15
24 ditë dhe jo më i gjatë se 15 vjet."

25 Dispozita (2) e të njëjtit artikull thotë:

1 "Gjykata mund të caktojë një ndëshkim, dënim me burg për,
2 me 20 vjet burgim, për vepra penale që për të cilat dënimi --
3 me vdekje parashikohet."

4 Krimi këtu në këtë rast do të ishte, përmbush kushtet e
5 dënimit me vdekje. Megjithatë, me shfuqizimin e dënimit me
6 vdekje përmes Rregullores së UNMIK-ut 24 të 12 dhjetorit 1979
7 [sipas përkthimit] neni 12 [sipas përkthimit] i Rregullores
8 thotë që dënimi me vdekje është hequr, Rregullorja ka hyrë në
9 fuqi më 10 qershor 1999.

10 Hapi në vijim ishte se Rregullorja 24 u ndryshua.
11 Rregullorja e re që hyri në fuqi ishte Rregullorja 2000/59, e
12 datës 27 tetor 2000. Neni 1.5 i Rregullores së mëparshme mbeti
13 në fuqi. Megjithatë, u fut një artikull, një nen i ri, neni
14 1.6 i cili parashihte dënimin maksimal prej 40 vitesh burgim
15 për vepra të cilat më parë dënoheshin me dënim me vdekje.

16 Pjesa 4 e kësaj Rregullore të UNMIK-ut parasheh një
17 dispozitë të përkohshme që ka të bëjë me këtë Rregullore. Kjo
18 do të, kjo hyn në fuqi pastaj më 27 tetor 2000, dhe saktëson
19 që pjesa e dytë, pjesa e re, pra 1.6 zbatohet vetëm ndaj
20 veprave penale që kryhen, janë kryer pas datës 27 tetor 2000.

21 Për rrjedhojë, duke mbajtur parasysh parimin e ndalimit
22 të efektit retroaktiv të Kodit Penal, nuk kishte asnjë bazë
23 ligjore për të caktuar dënimin maksimal për vepra penale të
24 kryera përpara datës 27 tetor 2000.

25 Dhe rrjedhimisht, Kodi Penal i Republikës Socialiste

1 Federative Jugosllave ishte baza ligjore për të caktuar
2 dënimin që ishte maksimum 15 vjet për vepra penale të kryera
3 përpara datës 27 tetor 2000.

4 Në dosjen e apelit, Mbrojtja paraqiti aktgjykimin e
5 Gjykatës Supreme të Kosovës. Në këtë aktgjykim lexohet
6 qëndrimi i saktë i Gjykatës Supreme lidhur me këtë pikë që
7 është çështja, pra e zbatimit të ligjit që ishte në fuqi në
8 momentin e kryerjes së veprës penale të aktakuzës së z.
9 Mustafa. Dhe vendimi rishtazi në këtë, mbi këtë çështje, thotë
10 po citoj: Me rregulloren e UNMIK-ut 1999/24 të datës 12
11 dhjetor 1999, e cila hyri në fuqi më datë 10 qershor 1999,
12 vendimi me vdekje u shfuqizua dhe nuk u përcaktuan dënime me
13 burgim afatgjatë si zëvendësim. Pra asnjë, nuk u -- nuk mbeti
14 alternativë ndaj dënimit me vdekje për ndëshkim me burg deri
15 në 15 burg. Kjo mbeti në fuqi pra.

16 Trupi Gjykses në paragrafin 781, sapo dëgjuan edhe nga
17 Prokuroria, konstatuan se ligji i zbatueshëm në atë kohë ishte
18 Kodi Penal i ish-Jugosllavisë. Në poshtëshënim thuhet se Trupi
19 Gjykses konstaton gjithashtu se ligjet vijuese relevante apo
20 kodet që u miratuan në Kosovë parashohin dënim të barabartë
21 ose më shumë, më të gjatë.

22 Megjithatë, Mbrojtja parashton se komentet e Trupit
23 Gjykses lidhur me këtë pikë nuk janë relevante. Asnjë nga
24 ligjet vijuese nuk janë të zbatueshme. Dhe sapo citova
25 Rregulloren e UNMIK-ut dhe në poshtëshënim të cilin përmendëm

1 më herët, Rregullorja tjetër pra, Rregullorja e cila nuk -- e
2 cila parashihte nenin 1.6, do të zbatohet vetëm ndaj krimeve
3 të kryera pas asaj dite. Dhe tani këtu i referohem Rregullores
4 2000/59, e cila ndryshon Rregulloren paraardhëse. Kjo
5 Rregullore saktëson qartësisht se pjesa e re zbatohet vetëm
6 ndaj krimeve të kryera pas datës 27 tetor, kjo është e
7 nënshkruar nga Bernard Kouchner, Përfaqësues Special i
8 Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të bashkuara.

9 Sidoqoftë, të nderuar Gjykatës, Rregullorja e UNMIK-ut e
10 cituar në këtë poshtëshënim të Trupit Gjykses, 781 pra, ky
11 poshtëshënim është i paplotë sepse ka lënë jashtë, nuk ka
12 përfshirë këto Rregullore konkrete, në veçanti.

13 Z. AMBOS: [Përkthim] Poshtëshënimi thatë është i paplotë,
14 por paragrafi i saktë, apo jo? Sepse ju vetë cituat kodin e
15 Republikës Federative Socialiste të Jugosllavisë, i cili është
16 zbatuar. Kështu që nuk e kuptoj tamam se çfarë, cili është
17 qëndrimi juaj në këtë pikë.

18 Z. VON BONE: [Përkthim] Pika, qëndrimi im që dhe pse në
19 poshtëshënim përmendet ligjet vijuese që vinin pasi ishin më
20 të ashpra, në fakt nuk ishte kështu. Sepse këto ligje kanë,
21 janë, kanë hyrë në fuqi me Rregulloren e ndryshuar dhe kjo
22 Rregullore rregullonte vetëm gjëra duke filluar nga data 27
23 tetor 2000. Por jo me efekt retroaktiv. Në atë rast, ngelet
24 neni 38 i Ligjit të ish-Jugosllavisë për ta thënë thjesht, i
25 cili parashihte një dënim me burgim deri në 15 vjet.

1 Pra, Trupi Gjykses gjithashtu citoi nenin 150 të Kodit
2 Penal të 20 prillit 2012, dhe po as ky ligj nuk është i
3 zbatueshëm në këtë rast, flasim për natyrisht për ligjin më të
4 butë, që hyri në fuqi pas vitit 2013, më 1 janar 2013.

5 Të gjitha këto për të thënë, të nderuar Gjykatës, se
6 Mbrojtja parashtron se Trupi Gjykses është i detyruar të
7 zbatojë nenin 44(2) që sigurisht, sipas kushtetutës mishëron
8 ligjin më të butë po ashtu. Siç thamë më herët, ligji më i
9 butë është i përfshirë edhe në kushtetutën e Kosovës, neni
10 33(2) dhe (4), dhe siç u tha më herët, edhe në standardet
11 ndërkombëtare.

12 Për rrjedhojë, Trupi Gjykses gaboi, duke caktuar dënim më
13 të lartë për krimin e torturës dhe atë të vrasjes, dhe duke
14 caktuar dënimin me 22 dhe 25 vite përkatësisht. Trupi Gjykses
15 tejkaloi, shkoi më tej ligjit të zbatueshëm lidhur me
16 ndëshkimin, dhe kjo është shkelje e kushtetutës, dhe në fakt
17 ky është i gjithë argumentimi sepse kjo zhvlerëson aktgjykimin
18 lidhur me përcaktimin e dënimit, këtë pjesë.

19 Për rrjedhojë, dënimi i zbatueshëm duhet, në atë kohë,
20 ndëshkon këto krime me një dënim maksimum prej 15 vjetësh
21 burgim.

22 Më lejoni të trajtoj edhe një gjë, të nderuar Gjykatës.
23 Është e rëndësishme të përmendim në rast se Paneli i Gjykatës
24 së Apelit është i mendimit, ose ka të njëjtin mendim si Trupi
25 Gjykses, ne propozojmë një vlerësim të përputhshmërisë së

1 ligjit me kushtetuesen, pra, kushtetueshmërinë e ligjit. Në të
2 njëjtin paragraf thuhet se Dhomat e Specializuara të Kosovës
3 duhet të zbatojnë, apo të marrin parasysh, apo fjala,
4 formulimi i saktë është "zbatojnë", "zbatojnë" kushtetutën e
5 Kosovës.

6 Dhe kjo është pikërisht arsyeja për të cilën kemi ngritur
7 këtë argument dhe për t'u kthyer tek Mbrojtësja e Viktimave,
8 kjo nuk është fare arsye për të ngadalësuar apo për të ndaluar
9 procedurën. Ajo që është e rëndësishme në këtë çështje është
10 që ligji i zbatuar dhe i zbatueshëm të jetë ai i sakti.

11 Z. AMBOS: [Përkthim] Dua ta qartësoj këtë sepse nuk e
12 kuptoj argumentin tuaj. Në poshtëshënimin 1629 --

13 Z. VON BONE: [Përkthim] Më lejoni ta gjej.

14 Z. AMBOS: [Përkthim] Një gjë është ajo që thoni ju, Trupi
15 Gjykues, nuk ka bërë verifikimin për të parë nëse ka një dënim
16 më të butë të zbatueshëm. A është ky argumenti juaj? Në qoftë
17 se është ky, atëherë duhet të na thoni që ajo që është cituar
18 në 1629 është i paplotë dhe që ekziston një dënim më i butë
19 nën, bazuar në ligjet e Kosovës.

20 Pra keni dy argumente. Ku është shkelja e ligjit më të
21 butë në këtë rast? Është bërë një krahasim, siç e diskutuam
22 edhe më herët, lidhur me këtë poshtëshënim. Ju mund të thoni
23 që është i paplotë, por Trupi Gjykues është përpjekur që të
24 bëjë një krahasim, por cila është dispozita standarde që të
25 jep një dënim më të ulët apo më të butë sesa neni 38 i

1 dispozitës të cilës u zbatua në këtë rast, dhe që shkon deri
2 në 15 vjet pra?

3 Z. VON BONE: [Përkthim] Më lejoni të përgjigjem.

4 Argumenti është si në vijim:

5 Ne besojmë që neni 38 i Kodit të Jugosllavisë ishte i
6 zbatueshëm dhe i vetmi që duhej të zbatohet. Nuk ka dyshim për
7 këtë. Doja të tregoja që neni 1629, Trupi Gjykues tha që nuk
8 kishte më vonë pas kësaj dispozite pra, mundësi për dënime më
9 të buta, por në këtë rast ata nuk kanë konsultuar këto
10 rregullore konkretisht. Ata e kanë lënë këtë pjesë hapur,
11 domethënë, dënimi me vdekje është shfuqizuar po nuk ka patur
12 dënim vijues që është vendosur pastaj.

13 Kjo është vendosur, zbatuar, me këtë rregullore të re.
14 Megjithatë, ata thuan, aty thuhet që kjo vlente vetëm për
15 krimet që kanë ndodhur pas datës 27 tetor 2000. Dhe
16 rrjedhimisht nga kjo pikëpamje, poshtëshënimi është i paplotë.

17 Z. AMBOS: [Përkthim] Ju kuptoj këtë, e kuptoj, por Trupi
18 Gjykues ka bërë krahasimin e nevojshëm bazuar në ligjin dhe
19 kushtetutën sepse janë, ato u përpoqën të gjejnë një ligj më
20 të butë.

21 Z. VON BONE: [Përkthim] Ajo që është e sigurt është që
22 ata nuk kanë zbatuar ligjin më të butë.

23 Z. AMBOS: [Përkthim] Po ju thatë që neni 38 është i
24 zbatueshëm. Ku është ligji më i zbatueshëm, më i butë këtu? A
25 mund të më citoni dispozitën ligjore në ligjin e Kosovës ku

1 ka, që është më i butë, që do të kishte dënim më të butë?

2 Z. VON BONE: [Përkthim] Nuk ka ligj më të butë sepse
3 ligjet vijuese pastaj asnjë prej tyre nuk ka qenë më i butë.
4 Për rrjedhojë, *lex mitior* dikton që duhet të kthehemi tek
5 ligji më në favor të të akuzuarit që ishte i zbatueshëm në
6 momentin kur kanë ndodhur ngjarjet. Kjo është e gjithë çështja
7 dhe kjo është arsyeja për të cilën përmenda dhe fola për
8 poshtëshënimin 1629 lidhur me këtë pikë.

9 Dhe këto çështje, janë, ekzistojnë edhe në jurisprudencën
10 e Kosovës. Një prej aktgjykimeve të Gjykatës Supreme në këtë
11 rast është ai i datës 20 mars 2023, numri i lëndës 2020-
12 017884, dhe numri i dosjes 26/2023. Dhe nga kjo -- e kemi
13 përfshirë këtë në anekset tona, si shtojcë. Gjykata Supreme e
14 Kosovës, në faqen 10, në paragrafin e fundit, trajtoi këtë
15 çështje.

16 Por për referencë është në faqen 10, paragrafi i fundit i
17 këtij aktgjykimi.

18 Ka dhe jurisprudencë, jurisprudencë tjetër nga Kosova
19 lidhur me këtë çështje, është rasti, çështja Darko Tasic, e
20 datës 31 mars 2022, numri i lëndës 1971. Dhe ky është vendim i
21 Gjykatës Kushtetuese. Vendim i datës 5 maj 2021. Kemi
22 gjithashtu në dispozicion versionin origjinal të Kosovës, por
23 të nderuar Gjykatës, do t'ju dorëzojmë edhe versionin në
24 anglisht të këtij dokumenti, versionin e përkthyer.

25 E rëndësishme lidhur me këtë pikë është fakti që gjykata

1 në këtë çështje vlerësoi dhe tani po citoj paragrafin 48:

2 "Duke marrë parasysh parimin e ndalimit të efektit
3 retroaktiv në kodin penal, si dhe faktin që nuk ka bazë
4 ligjore për të caktuar dënime maksimale, si edhe parimin e
5 zbatimit të ligjit më të favorshëm, Gjykata Supreme konstaton
6 se për të gjitha krimet, krimet penale të luftës, dhe krime të
7 tjera të kryera përpara datës 27 tetor 2000 për të cilat, dhe
8 për të cilat Kodi i ish-Jugosllavisë zbatohet, dënimi maksimal
9 është 15 vjet burgim".

10 Të nderuar Gjykatës -- këto ishin dy citime të Ligjit të
11 Kosovës. Nëse shohim çështjet nga TPNJ-ja, që mund të ishte
12 një analizë, mund të themi, e jurisprudencës, jurisprudenca
13 jep shembuj të shumtë të vrasjeve si rezultat i shkeljeve të
14 rënda, apo vrasje si krime kundër njerëzisë apo raste torture.
15 Dhe në shumë çështje të tilla, dënimet kanë qenë shumë më të
16 buta se sa kjo që kemi tani në këtë çështje.

17 Kemi çështjen e ICTY Kupreskic dhe të tjerë aktgjykimi,
18 që është IT-95-16-T, z. Drago Josipovic që ka kryer vrasje
19 ndaj shumë personave, dënimi maksimal ishte 15 vjet.

20 Në qoftë se shohim çështje të tjera që kanë bërë
21 jurisprudencë, për shembull çështja Kvočka që është në TPNJ,
22 98-31-T, Kvočka dhe të tjerë, vrasjet e shumta, të
23 shumëfishta, torturë e shumëfishtë. Vetë Kvočka u shpall
24 fajtor për vrasje dhe torturë dhe u dënua me shtatë vjet
25 burgim; Kos për vrasje dhe torturë 6 vjet; Radic për torturë,

1 katër raste torture, duke marrë parasysh pjesëmarrjen e tij
2 personale në gjithë këto krime, u dënua me 20 vjet burgim.

3 Në shumë raste, çështje të tjera, siç është Delalic dhe
4 Mucic, mund të -- do të mund të vazhdoja kështu me radhë. Në
5 rastin Kvočka, Miroslav Kvočka u konstatua fajtor në lidhje me
6 tre pika, me përndjekje, vrasje torturë, përdhunim, vrasje dhe
7 torturë sipas pikës 5, plus për vrasje sipas pikës 9, atij iu
8 dha një dënim i vetëm prej 7 vitesh burgim.

9 Z. Prcac, u shpall fajtor për tre akuza. Vrasje, torturë,
10 rrahje, dhe keqtrajtim seksual si pjesë e përndjekjes dhe
11 përveç kësaj dhe për vrasje si shkelje e ligjeve të zakoneve
12 te luftës dhe torturë si shkelje e zakoneve të luftës. Dhe u
13 dënua me një dënim të vetëm prej pesë vitesh.

14 Mund të vazhdoj me shembuj të pafund dhe ju kuptoj të
15 nderuar Gjykatës, se mund të thoni po ju e përzgjedhët këtë
16 argument apo atë argument. Atë që dua ta them është se po t'i
17 shikojmë çështjet para TPNJ-së dhe jurisprudencën që ka të
18 bëjë pak a shumë me të njëjtin kuadër kohor të ngjarjeve,
19 domethënë këtu flasim për 1999, atje flasim për 1992. Njerëzit
20 atje në atë gjykatë u dënuan ndoshta mbas 10 vitesh. Dhe
21 padyshim që kohëzgjatja e dënimit me burgim është e ndryshme.
22 Mirëpo, vija e kuqe që mund të tërhiqet është se në çështje të
23 vrasjeve të shumëfishta dënimet janë më të larta.

24 Këtu flasim për një rast të vetëm të vrasjes të një
25 personi të vetëm dhe kemi dënim prej 25 vitesh. Dhe flasim për

1 torturën e vetëm dy personave në lidhje me të cilët i akuzuari
2 pretendohet se i kreu vetë. Domethënë për të ashtuquajturin
3 synim eventual. Dhe në këtë kuptim, dua të shqyrtohet
4 jurisprudenca e Tribunalit Penal për Ish-Jugosllavinë sepse në
5 rastet para saj dënimet ishin shumë më të ulëta.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Do t'ju
7 ndërpres. Kam vetëm një pyetje në lidhje me çështjet para
8 TPNJ-së.

9 Në pikën 9(d) të Njoftimit për Apel, ju thoni se duhet të
10 bëhet një dallim midis atyre që mbajnë poste politike dhe
11 atyre që nuk mbajnë poste politike.

12 Z. VON BONE: [Përkthim] Po, ata që janë në poste politike
13 në shumë raste shohim që ata kanë përgjegjësi shtesë si të
14 thuash jo konkretisht në lidhje me njerëzit, por më shumë ndaj
15 civilëve dhe në shumë raste shohim se janë vetë kryesit si për
16 shembull Krnojelac. Ai ishte në një burg ku, në Bosnjë dhe
17 Hercegovinë, ku njerëzit u mbajtën të burgosur dhe u dënua për
18 kryerje të krimeve dhe e mori pjesën më të madhe të dënimit me
19 burgim në atë kohë.

20 Dhe kjo është i vetmi dallim që e kam bërë edhe tek
21 çështjet që lidhen me TPNJ-në, pra në lidhje me njerëz që
22 mbajnë poste të caktuara për shembull, ministri i punëve të
23 brendshme që ka detyrime të caktuara ndaj popullatës së vet,
24 domethënë këso lloj postesh.

25 Në ato raste, jemi më të zënë si të thuash me kryes që

1 janë në terren. Por gjithsesi, po t'i shikojmë rastet para
2 TPNJ-së dhe kjo është një çështje që unë mendoj se është shumë
3 e rëndësishme për t'u theksuar, elementi i kohës po kthehet
4 vazhdimisht në -- shpesh domethënë një kryes kryen një krim.
5 Persona qëndrojnë anash. E shikojnë personin. Dhe pastaj
6 kthehen. Dhe e shohin që ai person është i vdekur.

7 Pra, koha është relativisht e shkurtër dhe në ato raste
8 lidhja shkak-pasojë mund lehtësisht të bëhet. Mirëpo, në qoftë
9 se kemi 11 javë midis vdekjes, trupit të vdekur të një personi
10 që pretendohet se ka vdekur deri dikund nga data 19 prill, ne
11 kemi të bëjmë me një periudhë të stërzgjatur, bukur të gjatë
12 kohore midis ngjarjes dhe pasojës.

13 Unë do ta përfundoj këtu, të nderuar Gjykatës.

14 Z. Mustafa është deklaruar i pafajshëm që nga fillimi. Ai
15 nuk i ka njohur këta njerëz. Nuk ka pasur njohuri se kush
16 ishte aty. Dhe ai e ka thënë haptas këtë në Gjykatë se ai as
17 që i njihte këta njerëz, Mbrojtësen e Viktimave madje në një
18 rast tha që ky person u mor në pyetje, iu bënë pyetje mbas
19 pyetje.

20 Po, iu bënë pyetje atij personi, sepse ai person tha: E
21 di që e ka bërë. Mirëpo si e ke ditë se ai e ka bërë këtë? E
22 ke njohur përpara kësaj nga ai moment më vonë? Dhe kështu me
23 radhë.

24 Për atë arsye z. Mustafa gjykon se është e gabuar që u
25 konstatua fajësi dhe se dënimi që është dhënë është mjaft i

1 ashpër dhe jo proporcional.

2 Ju faleminderit, me kaq përfundoj parashtrimet e mia.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Ju

4 faleminderit.

5 Përpara se t'i japim fjalën z. Mustafa mund të kemi edhe
6 disa pyetje për ju.

7 Z. VON BONE: [Përkthim] I kam citimet për hir të
8 transkriptit.

9 Për referencat që i përmenda kemi transkriptin lidhur me
10 dëshmitarin 4600. Kemi transkriptin e datës 24 shtator të
11 vitit 2021, 4600, faqja e transkriptit 767, rreshtat 1-19, ku
12 ai thotë se e kishte dëgjuar këtë nga [REDAKTUAR].

13 [REDAKTUAR]

14 [REDAKTUAR]

15 [REDAKTUAR]

16 [REDAKTUAR]

17 [REDAKTUAR]

18 [REDAKTUAR]

19 [REDAKTUAR]. Pra është dëshmi e dorës së dytë që nuk konfirmon
20 burimin e pretenduar të informacionit.

21 Ju faleminderit.

22 Në qoftë se ka pyetje jam në dispozicionin tuaj.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim]

24 Faleminderit, duhet të ketë pyetje.

25 GJYKATËSJA JORGENSEN: [Përkthim] Kam një pyetje, dua t'ia

1 bëj ndoshta së pari ZPS-së dhe pastaj juve, z. Avokat.

2 Do t'i kthehem akuzës për vrasjen e paligjshme dhe
3 mosveprimin. Dua qartësim në qoftë se fokusohemi në
4 përgjegjësinë për mosveprim, në krahasim me përgjegjësinë për
5 veprime.

6 Si kjo e tejkalon çështjen e ndërhyrjes së një faktori të
7 ri dhe në lidhje me këtë atëherë si do të përkufizohet synimi
8 për vrasje në kontekstin e mosveprimit?

9 Z. BAARLINK: [Përkthim] Do t'i përgjigjem pyetjes së
10 parë. Sikurse theksuam dje, kontributi shkakësor sipas
11 parimeve themelore të shkakësisë e kalon këtë test. Pra,
12 kontributi i konsiderueshëm apo thelbësor, është i zbatueshëm
13 në rastet kur kemi faktorë të ri ndërhyrës. Mirëpo, në zbatim
14 është parimi i ligjit zakonor.

15 Madje edhe në atë rast ne kemi dhënë shembuj nga
16 jurisprudenca. Se parimi i ndërhyrjes së faktorëve të rinj nuk
17 është i zbatueshëm në lidhje me mosveprimin. Edhe në qoftë se
18 do të konstatojmë se ky element është pjesë e të drejtës
19 ndërkombëtare zakonore, kjo nuk do ta lironte z. Mustafa nga
20 përgjegjësia e tij për mosveprim.

21 Përgjegjësia për vrasje të paligjshme, në bazë të
22 mosveprimit është konfirmuar në shumë çështje të tjera
23 ndërkombëtare dhe kam dhanë citime në dosjen tonë.

24 Sa i përket synimit, elementi i synimit kriminal -- më
25 duhet vetëm një moment. Ka një referencë, e kemi përmendur në

1 dosjen tonë të përgjigjes, ndaj një aktgjykimi në Tribunalin
2 Ndërkombëtar Penal për Ruandën. Sigurisht që nuk do ta them
3 emrin si duhet, Ntagerura, është aktgjykimi i Trupit Gjykues,
4 në paragrafin 659, ku thuhet se:

5 "... kryesi ka vepruar me dijeninë dhe pajtimin se ato
6 pasoja do të ndodhin."

7 Për sa i përket synimit kriminal për mosveprimin, ky do
8 të ishte standardi i zbatueshëm.

9 GJYKATËSJA JORGENSEN: [Përkthim] Faleminderit.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Z. Von
11 Bone, doni t'i përgjigjeni kësaj pyetje?

12 Z. VON BONE: [Përkthim] Në qoftë se fokusohemi tek
13 mosveprimi, si kjo e zgjidh aspektin e ngjarjeve të reja
14 ndërhyrëse?

15 Përgjigjja e shkurtër është, e nderuar Gjykatëse, nuk bën
16 kurrfarë ndryshimi sepse edhe në rastin e mosveprimit duhet të
17 vërtetohet mosveprimi. Dhe të ketë një farë veprimi pozitiv
18 për atë mosveprim. Prandaj edhe citova çështjen Tadic, nuk më
19 kujtohet saktësisht numri i paragrafit, por në atë çështje
20 thuhet se duhet të jetë shumë e qartë se pavarësisht se për
21 çfarë veprimi apo mosveprimi bëhet fjalë, ai ka pasë për
22 pasojë vdekjen e një personi.

23 Dhe kjo duhet të vërtetohet, dhe të përcaktohet. Dhe
24 Trupi Gjykues këtë nuk e bëri në aktgjykim. Thjesht spekuloi
25 domethënë përmendi mohimin, moslirimin, mosevakuimin e kështu

1 me radhë. Për çfarë mosveprimesh jemi duke folur këtu?

2 Ky është përgjigja ime.

3 GJYKATËSJA JORGENSEN: [Përkthim] Faleminderit.

4 Z. AMBOS: [Përkthim] Kam një pyetje për ZPS-në dhe
5 Mbrojtjen në lidhje me pyetjen që ia bëra Mbrojtësen e
6 Viktimave më herët, si e shikoni zbatimin e nenit 21 të Kodit
7 Penal të Kosovës duke marrë parasysh nenin 12 të Ligjit të
8 DHSK-së?

9 Z. BAARLINK: [Përkthim] Kualifikimi kyç këtu është që të
10 jetë në përputhje me të drejtën zakonore ndërkombëtare. Në
11 qoftë se ka ndonjë dallim, atëherë duhet të, epërsi ka ligji
12 zakonor ndërkombëtar.

13 Z. AMBOS: [Përkthim] Mirëpo a ka ndonjë dallim?

14 Z. BAARLINK: [Përkthim] Nuk jam i sigurt. Duhet përpara
15 të kem dispozitat përkatëse t'i shikoj ato dhe t'ju jap një
16 parashtrim me shkrim në lidhje me këtë.

17 Z. AMBOS: [Përkthim] A mund të bëni një parashtrim të
18 shkurtër në lidhje me këtë me shkrim gjatë ditëve në vijim?

19 Thjesht të përgjigjeni në qoftë se simbas mendimit tuaj
20 është i zbatueshëm neni, apo mund të zbatohet neni 21.

21 Z. BAARLINK: [Përkthim] Padyshim që do t'ju bëj
22 parashtrimet e kërkuara me shkrim.

23 Por thjesht për të theksuar atë që e thashë edhe më
24 herët, në rrethanat e këtij rasti, kjo nuk do të bënte
25 kurrfarë ndryshimi, ose dallimi.

1 Z. VON BONE: [Përkthim] Është neni 12 i Ligjit, i Ligjit
2 të DHSK-së, në lidhje me nenin e ri 21 që e citoi Mbrojtësja e
3 Viktimave.

4 Z. AMBOS: [Përkthim] Kodi i Kosovës që mundëson
5 përdorimin e *dolus eventualis*.

6 Ky është elementi kyç i asaj që kërkoj unë në përgjigjet
7 tuaja.

8 [Anëtarët e Trupit Gjykues këshillohen]

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Besoj se
10 përfundam pyetjet.

11 Ju kërkoj palëve që t'i paraqesin parashtrimet me shkrim
12 brenda tre ditëve të ardhshme.

13 Z. BAARLINK: [Përkthim] Në rregull.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Domethënë,
15 sot jemi e premtë, përpara të mërkurës së javës që vjen.

16 Z. VON BONE: [Përkthim] Në rregull, të nderuar Gjykatës.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim]
18 Faleminderit.

19 Tani do ta dëgjojmë z. Mustafa, deklaratën personale të
20 tij në qoftë se dëshiron të bëjë një të tillë.

21 Keni dhjetë minuta në dispozicion z. Mustafa.

22 APELUESI: Përshëndetje, Trupi Gjykues, e nderuar
23 Gjykatëse. Unë kisha me thanë që edhe praktikisht edhe
24 moralisht ndihena i pafajshëm edhe pse juridikisht gjykata më
25 ka shpallë të fajshëm. Për shkak se jam i bindun që

1 absolutisht asnjë vepër për ato çka m'i ka ngarku Prokuroria
2 që tri vite nuk i kam konsumu. Edhe unë jam shumë i sigurt që
3 Prokuroria i ka të gjitha provat edhe din saktë që nuk ka
4 ndodhë ashtu. Edhe nuk është afër as një përqind të asaj, të
5 atij realiteti që ka ndodhë gjatë vitit 1999. Unë jam i bindun
6 që Prokuroria me dashje të gjitha argumentet i ka vendosë me
7 kokë teposhtë. Duke mos i pa, prej deklaratave fillestare të
8 vetë dëshmitarëve të Prokurorisë, e deri në marrjen e vendimit
9 prej Trupit Gjykses.

10 Prandaj s'kam diçka tjetër, kam besim në ju, unë jam
11 shumë i sigurt që edhe moralisht, edhe praktikisht jam i
12 pafajshëm.

13 Që ka ndonjë pyetje, jam i hapun për përgjigje.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Ne kemi
15 pyetje për juve. Faleminderit z. Mustafa, në qoftë se keni
16 përfunduar.

17 APELUESI: [Në anglisht] Yes.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Mirë
19 atëherë, këtu kemi përfunduar seancën e apelit për këtë
20 çështje. Përpara se sa të mbyll seancën e sotme, dua të
21 falënderoj palët pjesëmarrëse dhe zyrën administrative për
22 ndihmën që kanë dhënë për këtë seancë sot dhe dje. Po ashtu
23 dua të falënderoj përkthyesit për punën e bërë, ashtu si edhe
24 stenografët, teknikët audio-vizivë si dhe të gjithë personelin
25 tjetër për mbështetjen e tyre të shkëlqyer.

1 Trupi i Apelit do të japë vendimin e vet në momentin e
2 përshtatshëm.

3 Këtu përfundon seanca e apelit. Faleminderit.

4 --- Seanca mbyllet në orën 12.08

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25